



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.742/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Afijete Sada Gllgjani kryesuese, Burim Ademi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Albert Haxhaj, kandidat për anëtarë në Kuvendin Komunal në Komunën e Klinës, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Klinë, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, të paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të dt.03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar apeli Anr.742/2021, e paraqitur nga kandidati për anëtar në Kuvendin Komunal në Komunën e Klinës, Albert Haxhaj, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Klinë, e paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të dt.03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për Kuvendin Komunal, për shpalljen e rezultatit përfundimtar, me të cilën ka kërkuar që të rinumërohen votat në Vendvotimet nr. 0810C/01R 0812C/02D.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 03.11.2021, nga Albert Haxhaj, kandidati për anëtarë për Kuvendin Komunal në Komunën e Klinës nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se në vendvotimin 0810 C/01R në Volljak të Klinës i mungojnë dy vota dhe personat të cilët e kanë votuar janë familjar të tij me të cilën e kanë dëshmuar që e kanë votuar, por në këtë VV i figurojnë 0 vota. Në vendvotimin 0812C/02D pretendon se në bazë të dëshmitarëve i mungojnë 4 vota dhe në FPR janë shënuar 9 vota ndërsa sipas tij duhet të jenë 13 vota. Parashtruesi i apelit pretendon se këto vota i janë bartur kandidatës tjetër dhe po ajo kandidatë para votave me kusht ishte 8 vota mbrapa tij, ndërsa pas numrimit të votave me kusht ajo kishte marrur 11 vota me kusht dhe nga 34 që i kishte në vendvotimet në tërë Klinën dhe del fituese 2 vota më shumë se ai. Parashtruesi i apelit pretendon se rezultati i tij me nr.16 është 133 vota kurse kandidatës në fjalë me nr.12 i ka 135 vota.

Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur Formularin e Rezultateve për Kandidat (FRK) për VV e cekura në apel.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidati për anëtarë në Kuvendin Komunal në Komunën e Klinës, Albert Haxhaj, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), brenda afatit ligjor, ka parashtruar Apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në nr. 0810C/01R 0812C/02D, sa i përket numrit të votave për kandidat.

Paneli, me rastin e vendosjes së apelit ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga apeluasi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, ekipi hetues ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i apelit se në vendvotimin me numër 0810C/01R i njëjti posedon 0 vota dhe në vendvotimin 0812C/02D i njëjti posedon 9 vota.

Në fletëvotimet që janë rinumëruar del se kandidati me numër 16 nga subjekti politik LVV, nuk ka asnjë votë në vendvotimin me numër 0810C/01R të cilat janë shënuar në Formularin e Rezultateve për Kandidat-FRK dhe 9 vota i ka fituar në vendvotimin me numër 0812C/02D, dhe se të njëjtat vota iu janë shënuar në Formularin e Rezultateve për Kandidat-FRK.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 742/2021 më datën 06.11.2021.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.